

VENDIM
Nr.1154, datë 13.8.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS POJAN, TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Pojan, të qarkut të Korçës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Pojan, të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.793, datë 16.11.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Pojan, të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Pojan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Pojan

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-14	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
15-22	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
23-42	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
43-54	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
55-66	Varrezat publike	Në pronësi
67-74 (Vetëm trojet)	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
67-74 (Vetëm sheshet) 225-246	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
75	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shërbimit social	Në pronësi
77,78,92-127	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
79,81,83-86,88-90	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
80,82,87,91,255,256,267, 271-273,275,287,298,307,	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të	Në pronësi

309,314,320,333	ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive)	
334	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi